


Krimi i urrejtjes anti-semite



Krimi i urrejtjes anti-semite

Anti-semitizmi ka prekur komunitetet hebraike me mijëra vite, dhe gjeti shprehjen e tij më brutale në Holokaust, gjatë të cilit u vranë miliona hebrenj. Pavarësisht mësimëve që duhen nxjerrë nga kjo ngjarje e tmerrshme, anti-semitizmi vazhdon të pllakosë komunitetet hebraike edhe sot, duke u shtrirë nga teoritë e konspiracionit deri te diskursi jotolerant. Shumë shpesh, kjo intolerancë mund të kthehet në krime urrejtjeje anti-semite, duke përfshirë sulmet e dhunshme kundër hebrenjve. Ndikimi i këtyre krimeve mund të bëjë që personat hebraik të kenë frikë të marrin pjesë në shërbimet fetare, të mbajnë veshje ose simbole fetare, ose që ata t'i shmangen identifikimi publik si hebrenj qoftë kulturalisht ose për nga identiteti fetar. Kërcënimi që paraqesin krimet e urrejtjes anti-semite mund të detyrojë madje popullin hebraik të emigrojë. Anti-semitizmi nuk prek vetëm hebrenjtë, por mbarë shoqërinë. Ekzistenca e tij gjithashtu nxjerrë në pah prirje më të gjera të intolerancës ndaj grupeve të tjera, dhe të gjithë kanë një rol për të luajtur në luftën kundër kësaj dhe të gjitha formave të intolerancës.

Çfarë është krimi i urrejtjes?

**Vepër penale
+ Motivim nga paragjykimi
= Krim urrejtjeje**

- Krimet e urrejtjes përbëhen nga dy elemente: vepra penale dhe motivimi nga paragjykim
- Së pari, për t'u kryer një krim i urrejtjes, duhet të jetë kryer një shkelje themelore. Me fjalë të tjera, vepra e kryer duhet të paraqesë një kundërvajtje, sipas së drejtës penale. Nëse nuk ka krim themelor, nuk ka krim urrejtjeje. Nëse nuk ekziston një vepër penale, atëherë nuk ekziston as krimi i urrejtjes.
- Elementi i dytë i krimin të urrejtjes është se autori duhet të kryejë një vepër penale me një apo më shumë motive konkrete nga paragjykimi (të tilla si paragjykimi ndaj aftësisë së kufizuar, fesë, etnisë, ngjyrës së lëkurës dhe/ose gjinisë së viktimës). Prania e motivit nga paragjykimi është ajo që i dallon krimet e urrejtjes nga krimet e tjera.
- Një krim i urrejtjes është kryer në rastet kur autori me qëllim ka synuar një individ apo pronë për shkak të një apo më shumë veçorive të

mbrojtura, ose ka shprehur armiqësi ndaj veçorisë(ve) të mbrojtur(a) gjatë kryerjes së krimin.

Çfarë janë krimet anti-semite të urrejtjes?

Sulmet apo kërcënimet kundër njerëzve për shkak të identitetit të tyre aktual ose të perceptuar hebraik, ose synimi i personave apo pronave që lidhen me hebrenj apo komunitete hebraike, paraqesin krime të urrejtjes anti-semite. Paragjykimi manifestohet ose në përzgjedhjen e pikësnyimit (siç janë varreza, sinagogë, shkollë hebraike ose monument që përkujton viktimat e Holokaustit), ose në armiqësi anti-semite që shprehet gjatë kryerjes së krimin.

Krimet anti-semite të urrejtjes paraqiten kudo në rajonin e OSBE-së. Raporti i ODIHR-it tregon se incidentet e urrejtjes anti-semite përfshijnë sulme kundër hebrenjve si mbi baza fetare, ashtu edhe mbi baza etnike. Krime të tilla mund të ndodhin në ose përreth festave fetare hebraike dhe ditëve me rëndësi historike, duke përfshirë ditët përkujtimore të Holokaustit. Autorët e krimeve të tilla shpesh përdorin stereotipe të dëmshme,



Vigilje për përkujtimin të viktimave të sinagogës së Pitsburgut, 28 Tetor 2018, Uashington, DC.



Panel diskutimi i organizuar nga ODIHR dhe Museumi POLIN në Varshavë me theks të veçantë në rolin e arsimit në luftimin e anti-semitizmit dhe format e tjera të intolerancës, 28 Shtator 2016. (OSBE/ODIHR)

tregime dhe teori konspirimi rreth hebrenjve, dhe përdorin simbole historike (si svastika) për të kërcënuar viktimat dhe komunitetet e tyre.

Si të njohim krimet e urrejtjes anti-semite

Ka një numër treguesish që mund të ndihmojnë në identifikimin e një paragjykimi anti-semit në një krim të mundshëm të urrejtjes. Tregues të tillë, të njohur si „tregues të paragjykimit“, mund të nxisin autoritetet të hetojnë një krim si krim të urrejtjes anti-semite, duke mundësuar kështu një përgjigje të përshtatur.

Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë në identifikimin e krimeve të urrejtjes anti-semite:

- A e perceptojnë viktimat ose dëshmitarët incidentin si të motivuar nga paragjykimi kundër hebrenjve?
- A ka pasur komente, deklarata me shkrim, gjeste apo mbishkrime që dëshmojnë për një paragjykim? Këtu mund të përfshihen akuza tipike anti-semite, siç janë akuza ndaj hebrenjve për vrasjen e Krishtit ose vrasjen rituale të jo-hebrenjve (shpifja e gjakut), duke cituar teori konspirative rreth kompleteve hebraike për të kontrolluar botën, ose duke fajësuar të gjithë popullin hebre për politikën e qeverisë së Izraelit¹.
- A ishte prona e shënjestruar një lokacion me rëndësi fetare apo kulturore, si për shembull sinagogë, varrezë hebreje, shkollë ose pronë private hebrenjve?
- A ishte shënjestruar prona në fjalë më herët gjatë një incidenti anti-semit?

- Në rast të një sulmi kundër pronës, a u la një objekt ose simbol në vendngjarje që mund të perceptohej si fyes ose kërcënues, siç për shembull një simbol nazist? A u përdhos një send me rëndësi fetare, siç është një fletë e Tevratit?
- Cila ishte natyra e dhunës? A ishin në shënjestër simbolet që përfaqësonin Judaizmin? Për shembull, a është hequr një *kippah* nga koka e një personi?
- A i përket i dyshuari një grupi urrejtjeje që synon hebrenjtë? Këtu mund të përfshihen grupe të ndryshme ekstremiste djathtiste, apo grupe që avokojnë jotolerancën kundër hebrenjve. A tregon prejardhja ose evidenca penale e të dyshuarit se ka kryer vepra të ngjashme në të kaluarën, përfshirë edhe kundër grupeve të tjera?
- A është i dyshuari anëtar i një grupi të ndryshëm nga ai i viktimës?
- A ishte viktimë dukshëm e identifikueshme si hebre, për shembull, një burrë me një shami lutjeje, një person i veshur me veshje tradicionale, ose mbishkrime në gjuhën hebraike në veshjet ose bizhuteritë e tyre?
- A ishte viktimë udhëheqës i komunitetit hebre, apo mbrojtës i të drejtave të njeriut që merret me mbrojtjen dhe sigurinë e hebrenjve?
- A ndodhi incidenti në një datë me rëndësi qoftë për autorin e krimit ose për komunitetet hebraike (p.sh., Dita Përkujtimore Ndërkombëtare e Holokaustit, përvjetori i një sulmi terrorist ose një festë hebraike)?

- A ka ndonjë motiv tjetër të qartë? Mungesa e motiveve tjera është gjithashtu një arsye për të marrë në konsideratë motivin nga paragjykimi.

Krimet të urrejtjes anti-semite duhet të monitorohen dhe evidentohen si një kategori e veçantë e krimit. Kur një krim kryhet me motive të shumëfishta nga paragjykimi, secili prej këtyre paragjykimeve duhet të evidentohet dhe adresohet gjatë hetimit dhe ndjekjes penale. Të dhënat për krime të tilla duhet të ndahen sipas gjinisë, për të kuptuar më mirë shkallën në të cilën gratë dhe burrat hebrenjë preken nga krimet e tilla dhe për të zhvilluar përgjigjet e duhura. Gjatë hetimit dhe trajtimit të krimeve të urrejtjes anti-semite, është e rëndësishme të merren parasysh identitetet e shumëfishta të mundshme të viktimës (siç janë feja dhe etnia ose gjinia), pasi kjo mund të ketë pasoja të konsiderueshme për viktimat.

Raportimi i krimeve të urrejtjes anti-semite

Krimet të urrejtjes anti-semite, njëjtë si të gjitha krimet e urrejtjes, nuk raportohen mjaftueshëm, dhe kjo mund të jetë për një larmi arsyesh. Viktimave mund t'u mungojë besimi tek autoritetet, mund të mendojnë se pretendimi i tyre nuk do të merret seriozisht, ose mund të kenë frikë nga viktimizimi plotësues nga oficerët e policisë.

Aksesi efektiv në drejtësi mbetet një sfidë vendimtare për viktimat, dhe sfidë të cilën Shtetet pjesëmarrëse duhet ta adresojnë. Qeveritë kanë rolin kryesor që duhet ta luajnë në sigurimin e aksesit në drejtësi, duke u nisur nga vlerësimi fillestar i nevojave të viktimave që duhet të përmbushen nga oficerët e policisë, e deri tek zhvillimi i mekanizmave mbështetës për viktimat.

Shumë grupe të shoqërisë civile hebraike e kanë njohur rëndësinë e monitorimit të krimeve të urrejtjes, përfshirë si një mjet avokimi, dhe po zhvillojnë kapacitetet e tyre të monitorimit përmes punës në komunitet dhe raportimit në internet.

Shembuj të krimeve të urrejtjes anti-semite

- Njëmbëdhjetë adhures në një sinagogë u vranë gjatë një shërbimi të shtunën në mëngjes. Gjashtë vetë, duke përfshirë katër efektivë policie, u plagosën. Gjatë sulmit, kongregacioni ishte shënjestër e fyerjeve anti-semite dhe kërcënimeve me vdekje.
- Katër persona u vranë dhe 25 u mbajtën peng në një vetëshërbim kosher.
- Një familje hebraike u sulmua në shtëpinë e saj. Burri u lidh, gruaja u përdhunua dhe apartamenti u plaçkit. Sulmuesit bënë komente të tilla, si „ju hebrenjtë, keni para“ dhe „ju hebrenjtë, paratë i mbani në shtëpi, jo në bankë“.
- Një e mbijetuar 85-vjeçare e Holokaustit u godit për vdekje me thikë në shtëpinë e saj përpara se apartamentit të saj t'i vihej zjarri nga dy kriminelë, të cilët mendonin se viktimë është e pasur sepse ishte hebreje.
- Gjashtë nxënës hebrenj të identifikueshëm në pamje iu nënshtruan shpifjeve anti-semite dhe u sulmuan.
- Një svastikë u gdhend në një pllakë që i dedikonte një shkollë Ana Frankut.

¹ Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së „deklaruan qartë se zhvillimet ndërkombëtare, përfshirë në lidhje me situatën në Lindjen e Mesme, kurrë nuk e justifikojnë anti-semitizmin.“ OSCE Ministerial Council, „Declaration on Enhancing Efforts to Combat Anti-Semitism“, Basel, 5 December 2014 [MC.DOC/8/14], <https://www.osce.org/cio/130556?download=true>.

Për të qenë efektive, përgjigjet e policisë dhe politikat e qeverisë për të luftuar krimet e urrejtjes anti-semite duhet të bazohen në prova dhe të bazohen në të dhëna zyrtare mbi krimin e urrejtjes, si dhe në raportet e shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Ndërgjegjësimi i shtuar publik mbi krimet e urrejtjes, evidentimi i krimeve të urrejtjes nga shtetet pjesëmarrëse, masat për inkurajimin e denoncimit nga viktimat, dhe monitorimi dhe raportimi i shoqërisë civile do të ndihmojnë zbulimin e shtrirjes së problemit në më shumë detaje, duke u mundësuar politikëbërësve të identifikojnë përgjigjet e duhura.

Çfarë mund të bëni?

Ekzistojnë shumë organizata që ndihmojnë viktimat e krimeve të urrejtjes. Organet e barazisë, Avokati i Popullit që adresojnë diskriminimin, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat lokale hebraike luajnë rolin kryesor në luftimin e krimeve të urrejtjes. Ato shërbejnë si një lidhje jetike midis viktimave, komuniteteve dhe autoriteteve lokale. Ju mund të kontaktoni këto organizata, shoqatën tuaj lokale të mbështetjes ose Avokatin e Popullit për të mësuar më shumë rreth krimeve të urrejtjes anti-semite:

- Kongresi Botëror i Hebrenjve:
<https://www.worldjewishcongress.org/en>
- Kongresi Evropian i Hebrenjve:
<https://eurojewcong.org/>

- Lidhja Antishpifje – Antisemitizmi:
<https://www.adl.org/anti-semitism>
- Equinet – Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë:
<http://www.equineteurope.org/>
- Instituti Ndërkombëtar i Avokatit të Popullit (IOI):
www.theioi.org
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI): <http://ennhri.org/>

Udhëzuesit e ODIHR-it për krimet e urrejtjes





ODIHR-i ka përpiluar praktika të mira nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në adresimin e krimeve të urrejtjes dhe i ka ndarë ato në disa botime, gjendet në faqen tonë të internetit në:

<https://www.osce.org/odihr/guides-related-to-hate-crime>

ODIHR-i ka botuar dhe një udhëzues praktik mbi *Të kuptuarit e krimeve të urrejtjes anti-myslimane, adresimin e nevojave të sigurisë së komuniteteve myslimane*: gjendet në:

<https://www.osce.org/odihr/317166>

Mësoni më tepër rreth krimeve të urrejtjes anti-semite dhe mënyrës se si organizatat e shoqërisë civile mund të raportojnë incidentet tek ODIHR, duke vizituar faqen tonë të internetit të destinuar për Raportimin e Krimin të Urrëjtjes në: www.hatecrime.osce.org



Më shumë informacione:

Për informacione më të hollësishme rreth nismave të ODIHR-it për krimet e urrejtjes dhe për të parë gamën e plotë të burimeve dhe publikimeve, vizitoni:

www.osce.org/odihr/tolerance

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ul. Miodowa 10 00-251
Varshavë, Poloni

Tel.: +48 22 520 0600

Faks: +48 22 520 0605

E-mail: tndinfo@odihr.pl

